



Datë: 15.09.2025

Numër Protokolli: 6568/2025

A.nr.1276/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1276/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesja G.L kundër organit të punësimit: Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, me objekt ankese “*vlerësimi i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 15.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si pabazuar ankesa me numër A.nr.1276/2025, e datës 03.07.2025, e parashtruar nga ankuesja G.L.

II. Mbeten në fuqi Formularët për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen, të datës 02.06.2025 si dhe datës 03.06.2025.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, G.L. (*tutje referuar vetëm ankuesja*), më datë 02.07.2025, përmes emailit ankesa.kpmsbck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 03.07.2025 dhe protokolluar me numër 4477/2025, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Autoriteti i Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ndërsa, ky i fundit, më datë 15.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 5514/2025 të datës 15.08.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesja edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: *Kolegji i Këshillit*) ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4477/2025, të datës 03.07.2025, të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 02.06.2025, me korrespondim prej 2 faqeve; Formularin e vlerësimit të punës të datës 02.06.2025; E-mailin e datës 25.03.2025; E-mailin e datës 21.10.2024, me korrespondim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 17.10.2024; E-mailin e datës 23.10.2024, me korrespondim prej 5 faqeve; Ankesën e datës 25.04.2025; E-mailin e datës 07.08.2024; E-mailin e datës 11.07.2024; Formularin e vlerësimit të punës të datës 03.06.2025; Raportin javor (pa datë) ; Raportin javor nga data 10.06-28.06.2024; Dokument identifikimi; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.07.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 17.07.2025; Akt emërimit me numër protokolli 664/23-07/B, të datës 29.12.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 04.01.2024; Akt emërimit me numër protokolli 665/233-07/B, të datës 29.12.2023; Vendimin me numër protokolli 486/24-06/B, të datës 30.07.2024; Vendimin me numër protokolli 78/25-06/B, të datës 11.02.2025; Vërejtjen me shkrim me numër protokolli 640/24-10/B të datës 26.09.2024; E-mailin e datës 02.06.2025, me korrespondim prej 2 faqeve; E-mailin e datës 03.06.2025, me korrespondim prej 3 faqev; E-mailin e datës 04.06.2025.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse**:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja, është e punësuar në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas Akt emërimit numër protokolli 664/23-07/B, të datës 29.12.2023, në pozitën e punës "*Inspektore Hetuese e Konkurrencës*".

Si rrjedhojë, ankueses për vitin 2024, i janë realizuar tri vlerësime të rezultateve të punës, gjegjësisht sipas Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, të datës 26.02.2025, të z.Sh.E- Inspektor për hetimet e shkeljeve të konkurrencës në treg, i cili sipas Vendimit me numër protokolli 219/23-06/B të datës 16.05.2023, të U.D Drejtorit të Përgjithshëm, ishte emëruar U.D Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes të Tregut, pozitë të cilin e kishte ushtruar deri në nxjerrjen e Vendimit me numër protokolli 101/24-06/B, të datës 14.02.2024, të Drejtorit të Përgjithshëm, përmes të cilit ishte shfuqizuar vendimi paraprak për emërimin e tij në këtë pozitë, ankuesen në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, për periudhën kohore nga data 01.01.2024 deri më 14.02.2024, e ka vlerësuar me nivelin: ***tejkalon pritshmëritë***.

Tutje, për periudhën nga data 15.02.2024 deri më 31.07.2024, z. S.B-Drejtori i Përgjithshëm i AKRK-së, në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, të njëjtën përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve të Punës, të datës 26.02.2025, e ka vlerësuar me nivelin: ***ka nevojë për përmirësim***.

Ndërsa, sipas Formularit për Vlerësimin e Rezultateve të Punës, të datës 27.02.2025, z. A.R- Inspektor Hetues i Konkurrencës, i cili sipas Vendimit Nr.37/24 të datës 30.07.2024, është emëruar Ushtrues Detyre i Udhëheqësit të Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar, ankuesen në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të saj, për periudhën e mbetur të vitit 2024, e ka vlerësuar me nivelin: ***ka nevojë për përmirësim***.

Ankuesja, ndaj këtyre Formularëve të vlerësimit të rezultateve të punës, me datë 04.03.2025 kishte parashtruar në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi pretendimet se Drejtori i Përgjithshëm për periudhën e njëjte kohore e ka vlerësuar të njëjtën dy here, përkatësisht më datë 24.06.2024 kur i është konfirmuar marrëdhënia e punës, duke theksuar ndër të tjera se vlerësimi i dytë për periudhën e njëjtë është tendencioz, ndërsa sa i përket vlerësimit të z. A.R, ankuesja kishte theksuar se i njëjti nuk mund ta vlerësoj sepse e njëjta më datë 15.08.2024, ka parashtruar kërkesë për ndërrimin e divizionit, ashtu që ankuesja ka kërkuar aprovimin e ankesës, anulimin e

Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë të datës 25.02.2025, të Sekretariatit të AKRK-së, me obligimin që Njësia e Burimeve Njerëzore ta largoj nga dosja personale vlerësimin e ankueses.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin A.nr.417/2025 të datës 08.05.2025, kishte anuluar Vlerësimet e rezultateve të punës për vitin 2024, për ankuesen, duke obliguar me këtë rast mbikëqyrësit e saj të drejtpërdrejtë që për periudhat përkatëse, të ndërmarrin veprimet që ankueses ti bëhet rivlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2024, përkatësisht që Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ta rivlerësoj të njëjtën për periudhën nga data 25.06.2024 deri më 31.07.2024, ndërsa U.D Udhëheqësi i Divizionit për Marrëveshjet e Ndaluar, në Autoritetin e Konkurrencës së Republikës së Kosovës, ta rivlerësoj ankuesen për periudhën nga data 01.08.2024 deri më 31.12.2024.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rezulton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës dhe U.D Udhëheqësi i Divizionit për Marrëveshjet e Ndaluar në cilësi të mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të ankueses, më datë 02.06.2025 dhe 03.06.2025, kanë bërë vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen për periudhën 25.06.2024 deri më 31.07.2024 respektivisht për periudhën nga data 01.08.2024 deri më 31.12.2024, dhe atë me nivel të përgjithshëm të vlerësimit “*ka nevojë për përmirësim*”, rrjedhimisht nga analizimi i këtyre formularëve rezulton se të njëjti e kanë vlerësuar me nivel të njëjtë tek të gjitha fushat përkatëse ankuesen. Me konkretisht, lidhur me objektiven nr. 1: Monitorimi i tregjeve në Republikën e Kosovës në fushën e konkurrencës dhe analiza e tregut, është vlerësuar me nivelin “*arrin pritshmëritë*”, ndërsa lidhur me objektivin nr.2: Hetimi i shkeljeve të konkurrencës në treg dhe objektivin nr.3: Vlerësimi i marrëveshjeve të ndaluara, është vlerësuar me nivelin “*ka nevojë për përmirësim*”. Lidhur me pjesën e aftësive profesionale sipas pikave 1.1 –aftësitë analitike, është vlerësuar me nivelin “*ka nevojë për përmirësim*”; 1.2 -iniciativa dhe kreativiteti, është vlerësuar me nivelim “*e papranueshme*”; 1.3-komunikimi efektiv, është vlerësuar me nivelim “*e papranueshme*”; 1.4- bashkëpunimi dhe puna në ekip, është vlerësuar me nivelim “*ka nevojë për përmirësim*”; 1.5-adoptimi dhe fleksibiliteti, është vlerësuar me nivelim “*tejkalon pritshmëritë*”; 1.6- respektimi i rregullave dhe procedurave, është vlerësuar me nivelim “*arrin pritshmëritë*”, kurse, lidhur me IV. Vlerësimi i aftësive metodologjike, personale dhe sociale, është vlerësuar me nivelim “*e papranueshme*”.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se vlerësimi i vitit 2024 nuk vërteton saktë gjendjen faktike dhe si njëjti nuk është objektiv dhe i paanshëm, por është me tendencë dhe mungesë profesionalizmi, duke marrë për bazë raportet personale, si rrjedhojë e kësaj e njëjta kërkon aprovimin e ankesës dhe anulimin e formularëve përkatës.

Në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ju referuar bazës ligjore në fuqi që rregullon çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë, gjegjësisht Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, me theks të veçantë nenit 52, me të cilin është përcaktuar se: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të paracaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së*

burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 7. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë profesionale dhe kategorisë së specialistes/it vlerësohet nga mbikëqyrësja/ie saj/tij i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përfjashtimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme....”

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor të lartë theksuar Kolegji i Këshillit, ka analizuar aktet e kontestuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë erdhi në përfundimin së ankuesja më asnjë provë nuk ka rritur të argumentoj pretendimet e saj ankimore lidhur me vlerësimin jo objektiv, të paanshëm, por me tendencë dhe mungesë profesionalizmi të rezultateve në punë për vitin 2024, për më tepër ankuesja më rastin e parashtrimit të ankesës, përveç thënieve si në ankesë, nuk ka ofruar dëshmi që provojnë se e njëjta ka përmbushur objektivat e punës, për pozitën e punës të Inspektore Hetuese të Konkurrencës, ngase e njëjta për tërë këtë periudhë kohore të vlerësimit të rezultateve të punës, ka bashkangjitur vetëm dy raporte, gjegjësisht Raportin javor (pa datë) të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut- Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar si dhe Raportin javor nga data 10.06-28.06.2024, të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut- Divizionit të Marrëveshjeve të Ndaluar, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, këto dy raporte javore nuk janë prova bindëse, që dëshmojnë se ankuesja ka arritur përmbushjen e objektivave dhe detyrave të punës.

Andaj, në kuptim të gjendjes së faktike të evidentuar si më lartë dhe duke qenë së ankuesja nuk ka arritur të argumentoj pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e datës 03.07.2025, Kolegji i Këshillit konstaton së ankesa është e pabazuar dhe për rrjedhojë vlerësimi rezultateve në punë për ankuesen i vitit 2024 është i drejtë, kështu që, mbi këtë bazë, aktet e kontestuar rezultojnë se janë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Theksuar më sipër, e në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 132 paragrafi 2 të LPPA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1276/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, G.L;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në AKRK; si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.